



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 27 janar 2023
Kodi i ZRRE-së: V_1664_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenit 9 paagrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 par. 1 nënpar. 1.2 dhe Nenin 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenit 28 par. 1 nënpar. 1.12 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Nenin 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 12/2017 për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
- Nenin 9 par. 6 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes ;
- Parimet për Përcaktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Taksave të Kçjes në Sistemin e Shpërndarjes;
- Metodologjinë e Taksave të Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH) të aprovuar me Vendimin V_1543_2022 dt. 29 korrik 2022 nga Bordi i ZRRE, dhe
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) të datës 05.09.2022 për shqyrtim dhe aprovim të Taksave për Kçje në Rrjetin e OSSH-së,

në seancën e mbajtur me datë 27 janar 2023, nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN - Taksat e Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH).**
- II. Taksat e Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH), do të fillojnë të aplikohen nga data 1 mars 2023.**
- III. Taksat e Kçjes do të jenë pjesë përbërëse e Metodologjisë së Taksave të Kçjes të aprovuar me Vendimin V_1543_2022 dt. 29 korrik 2022 nga Bordi i ZRRE.**



Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05.09.2022 ka pranuar kërkesën për aprovim të Taksave të Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH) nga subjekti juridik KEDS SH.A, sipas kërkesave ligjore të kërkuara me Metodologjinë e Taksave të Kçjes, ku është theksuar se implementimi i Metodologjisë do të filloj me aprovimin e Taksave të Kçjes sipas Vendimit të Bordi të ZRRE-së.
 - ZRRE me datë 27.04.2022 kishte pranuar kërkesën për aprovim të Metodologjisë së Taksave të Kçjes në Rrjetin e Distribucionit (OSSH) nga subjekti juridik KEDS SH.A.
 - Metodologjia e taksave të Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes, përcakton obligimet e OSSH-së, që të ofron shërbime të energjisë elektrike, për përdoruesit ekzistues që shfrytëzojnë këto shërbime, si dhe për përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes të cilat kërkojnë kçje në rrjetin e OSSH-së.
 - ZRRE me datë 29 korrik 2022 përmes Vendimit V_1543_2022 pas vlerësimit dhe analizimit të dokumentit dhe shqyrtimit të tyre, ka konsideruar se janë përmbushur kriteret për aprovim të Metodologjisë së Taksave të Kçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH), e cila do të zbatohet pas aprovimit të Taksave të Kçjes sipas Vendimit të Bordit të ZRRE.
 - ZRRE ka kërkuar nga ana e subjektit juridik KEDS SH.A., që të përgatis Taksat e Kçjes sipas kushteve të përcaktuara me Metodologjinë e Taksave të Kçjes së Rrjetin e Distribucionit (OSSH), ku taksat të parapara si në Shtojca duhet të jenë të bazuara në çmimet e tregut, dhe duhet ti dërgohen ZRRE-së, dhe të publikohen në faqen elektronike të OSSH dhe të ZRRE-së.
 - ZRRE mban të drejtën që të kërkoj nga OSSH që të publikoj kapacitetet e stabilimenteve elektronergjetike në çdo kohë, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.
 - ZRRE pas vlerësimit të Shtojcave me taksave për shërbimet e Kçjes në Rrjetin e OSSH-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore që lista e taksave të kçjes të propozohet për shqyrtim dhe aprovim në Bord të ZRRE-së.
 - Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të Listës së Taksave, ka konsideruar se janë përcaktuar Taksat sipas Metodologjisë së Taksave të Kçjes s Rrjetin e Distribucionit (OSSH) të aprovuar nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimit i bashkëngjitet:

Lista e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes (OSSH).


Bordi i ZRRE-së,


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Izet Rushiti, Anëtar


Selman Hopti, Anëtar


Lutfie Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KEDS, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Tabela 1: Tabela e shërbimeve të kyçje

Nr.	Taksat për shërbimin e kyçjes	€
1	Në rrjetin 0.4 kV(kyçje e re e thjeshte)	57
2	Në rrjetin 0.4 kV	63
3	Në rrjetin 10 kV	83
4	Në rrjetin 35 kV	113

Tabela: 2. Taksat për kapacitet indikative për kostot për njësi kVA

Kosto për Kapacitet		
	Niveli i tensionit	Mesatarja për 1 kVA*
2	për 0.4 kV	90
3	për 10 kV	80
4	për 35 kV	70

Tabela 3. Taksat per shërbime tjera

Nr.	Shërbimet	€
1	Ndërrim i njehsorit njëfazor me trefazor	20
2	Ndërrim i njehsorit trefazor me trefazor	20
3	Instalimi dhe bllombimi i njehsorit trefazor duke përfshirë edhe instalimin e njehsorëve për objekte banesore për kyçje të re	20
4	Ndërrim i emrit të konsumatorit	2
5	Kontrollimi i njehsorit shtëpiak dhe jo shtëpiak të vegjël me kërkesë të konsumatorit – në vendngjarje	20
7	Bllombimi i pikës matëse	10
8	Pregatitja e pelqimit elektroenegjetik	25
9	Testimi i sistemit matës -0.4 kV me matje gjysemindirekte – në vendngjarje	40
10	Testimi i sistemit matës - 10(20)kV dhe 35 kV- tension të mesëm me matje indirekte – në vendngjarje	90
11	Pranimi teknik	60
12	Pergatitja e ofertes per Kyqje	50
13	Ri-inspektimi për pranim teknik	60
14	Shkyçje përkohshme/pasivizimi Në rrjetin 0.4 kV(kyçje e re e thjeshte)	15

15	Për Zgjidhje Teknike		70
16	Rikycja pas pasivizimit/aktivizimi Në rrjetin 0.4 kV(kycje e re e thjeshte)		15
17	Ndërrimi i TMRR- ve për njësi - tension i ulët		15
18	Ndërrimi i TMRR- ve për njësi - tension i mesem		30
19	Ndërrimi i TMT- ve për njësi - tension i mesem		30
20	Shqyrtimi I kablove nentokesore per palet e treta ore pune		120
21	Zhvendosja e njehsorit në rrjetin 0.4 kV (kycje e re e thjeshte) me kerkese te konsumatorit		80
22	Instalimi i njehsorit me matje gjysmeindirekte - ku paraprakisht janë instaluar TMRR-të		50
23	Instalimi i njehsorit me matje indirekte- ku paraprakisht janë instaluar TMRR-të dhe TMT-të		80
24	Shkycje/rikycja përkohshme/pasivizimi/rikycja Në rrjetin 0.4 kV(matje gjysëm indirekte)		30
25	Shkycje/rikycja përkohshme/pasivizimi Në rrjetin e tensionit te mesem		50
26	Aprovimi I Projektit		30